

VENDIMI PËR PEZULLIM

Nr: 029/1/2019

Subjekti	“KASTRATI” Sh.p.k
Adresa:	Rr. “Kreshnik Ademaj” Pejë
Fusha:	Trup Inspektues për Homologimin e Automjeteve

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-117 për Akreditim, kërkesat e standardit ISO/IEC 17011, pika 7.9.8 dhe procedurën e akreditimit DAK-PT-001, pika 6.12 Drejtorja e Përgjithshme e DAK-së merr:

**VENDIM PËR PEZULLIM TË AKREDITIMIT PËR
TVK-në “KASTRATI” Sh.p.k**

Arsyetim: Ky vendim merret për shkak të mos përmbushjes së obligimeve dhe detyrimeve nga ana e TI-së “KASTRATI” Sh.p.k. të përcaktuara në kontratë e lidhur në mes DAK dhe TI-së më datë 24.08.2016 konkretisht pikës 13, 15, 17, 18 të Nenit 4: Të drejtat dhe obligimet e TVK-së ndaj DAK-së.

Më qëllim të përmbushjes së kërkesave të standardit ISO/IEC 17011 si dhe bazuar në procedurën e akreditimit DAK-PT-001 pika 6.12 Mbikëqyrja e akreditimit, DAK me datën 01.04.2019 ka njoftuar TVK-në për vizitën vlerësuese/mbikëqyrëse që do të realizoj gjatë javës së dytë të muajit prill 2019.

Sipas procedurës DAK PT-001 pika 6.6.2 TVK është e obliguar që të kthej përgjigje nëse është dakord me ekipin e vlerësimit si dhe datën e vlerësimit duke plotësuar formën PT-001-F05 brenda 3 ditëve të punës nga data e dorëzimit të formularit. Me këtë rast përfaqësuesi i këtij trupi inspektues përmes bisedës telefonike ka kërkuar që mbikëqyrja të shtyhet për një afat tjetër kohor dhe DAK ka pranuar kërkesën e tyre gjithnjë duke ju përmbajtur rregullave dhe procedurave që i kërkon akreditimi.

Me qëllim të përmbajtës së afateve kohore dhe përmbushjes së kërkesës së standardit ISO/IEC 17011 pika 7.9.3 më datën 19.07.2019 DAK e ka njoftuar përfaqësuesin e TI përmes shkresës elektronike për datën e planifikuar të realizimit të mbikëqyrjes, mirëpo përsëri përfaqësuesi i TI-së, më datën 02.08.2019 ka kërkuar që të shtyhet vizita vlerësuese për muajin shtator 2019 me arsyen se punonjësit e TI që janë kompetent për fushën e Inspektimit të homologimit të automjeteve gjinden në pushim vjetor. Pas konsultimit me stafin e DAK-së një gjë e tillë është aprovuar.

Më datë 19.09.2019 i'është përcjellë vërejtja e fundit për vizitën mbikëqyrëse, mirëpo DAK nuk ka marr ndonjë përgjigje nga përfaqësuesi i TI në fjalë.

Andaj me sa u tha me lart, për shkak të mos përmbushjes së obligimeve dhe detyrimeve nga ana e TI-së “KASTRATI” Sh.p.k. DAK merr vendim për pezullim të fushës së akreditimit homologimi i automjeteve për 6 (gjashtë) muaj nga data e nënshkrimit të këtij vendimi..

Vërejtje: Në rast se gjatë kësaj periudhe TVK nuk plotson kërkesat e DAK-së, atëherë DAK vazhdon me procedurat tjera për tërheqjen e akreditimit..

Prishtinë: 11.10.2019

Drejtorja e Përgjithshme e DAK-së
Gentiana Islamaj